



**MONITORIMI I KORRUPSIONIT NË
SHQIPËRI 2025**



Funded by
the European Union

Copyright © 2025, [Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike](#) (ACER), [Lidershipi i Europës Juglindore për Zhvillim dhe Integritet](#) (SELDI)

Publikuesi: Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER)

Titulli i Projektit: Shoqëria Civile për Mirëqeverisje dhe Anti-Korrupsion në Europën Juglindore

Akronimi i Projektit: SELDI (Lidershipi i Europës Juglindore për Zhvillim dhe Integritet)

Skema e Financimit: Programet e Partneritetit të Komisionit Europian për Organizatat e Shoqërisë Civile

Koordinatorë të Projektit: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCIC), Maqedonia e Veriut

Sondazhi: [Center for Economic and Social Studies](#) (CESS)

Partner i Projektit në Shqipëri: [Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim](#) (IDM)

Koordinimi i kërkimit dhe përgatitja e raportit:

Zef Preçi

Endri Deda

Aida Myftaraj



Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Europian. Përmbajta e këtij dokumenti është përgjegjësi e iniciativës së SELDI-it dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen si pikëpamje të Bashkimit Europian.

Tabela e përmbajtjes

1. Përmbledhje Ekzekutive	6
2. Hyrje	8
3. Metodologjia e Monitorimit të Korrupsionit (CMS).....	9
4. Nivelet e korrupsionit në Shqipëri	11
4.1 Dënimet në lidhje me korrupsionin	11
5. Rezultatet e Sistemit të Monitorimit të Korrupsionit 2025	14
5.1 Përvoja me korrupsionin	14
5.1.1 Presioni i korrupsionit dhe përfshirja në korrupsion	14
5.1.2 Rezistenca ndaj presionit te korrupsionit.....	15
5.2 Sjelljet ndaj Korrupsionit.....	16
5.3 Perceptimet mbi Korrupsionin	18
5.4 Shtrirja e korrupsionit	22
6. Përfundimet dhe Rekomandimet kryesore	25
6.1 Përfundimet kryesore	25
6.2 Rekomandime kryesore.....	26

Lista e figurave

Figura 1. Indikatorët e vlerësimit të korrupsionit nga Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit	10
Figura 2. Numri i personave të dënuar për korrupsion dhe shpërdorim detyre (2004-2024) ...	12
Figura 3. Presioni i korrupsionit dhe përfshirja në korrupsion.....	15
Figura 4. Rezistenca ndaj presionit të korrupsionit.....	16
Figura 5. Pranimi i korrupsionit	17
Figura 6. Ndjeshmëria ndaj korrupsionit.....	18
Figura 7. Perceptimet e korrupsionit për zyrtarët publik – më të korruptuarit	19
Figura 8. Perceptimet e korrupsionit për zyrtarët publik – më pak të korruptuarit.....	19
Figura 9. Ndryshimi i perceptimit mbi korrupsionit mbi zyrtarët publikë (2023-2025).....	20
Figura 10. Perceptimet mbi mundësinë për korrupsion (%)	21
Figura 11. Perceptimet mbi realizueshmërinë e politikave kundër korrupsionit (%).....	22
Figura 12. Korrupsioni i shpërndarë në 12 qarqe.....	23
Figura 13. Vendimet e qeverisë në shërbim të interesave personale.....	24

Lista e akronimeve

ACER	Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike
CESS	Qendra për Studimet Ekonomike dhe Sociale
CMS	Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit
CSD	Qendra për Studime Demokratike
CSDG	Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
RCC	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
SELDI	Lidershipi i Europës Juglindore për Zhvillim dhe Integritet
SPAK	Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

1. Përmbledhje Ekzekutive

Korrupsioni po pengon përparimin më të shpejtë të Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian.

Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit (CMS) 2025 tregon se **korrupsioni është një pengesë serioze për përparimin më të shpejtë të Shqipërisë drejt BE-së**, por rritja e besimit të qytetarëve në suksesin e luftës kundër korrupsionit tregon se ndryshimi për mirë po ndodh në të gjithë vendin. Hulumtimet zbulojnë gjithashtu se korrupsioni mbetet një kërcënim i madh për funksionimin normal të administratës publike. Ai pengon uljen e kostos së shërbimeve publike dhe zvogëlimin e vendimmarrjes në kushte konflikti interesi.

Të dhënat e CMS për vitin 2025 në Shqipëri tregojnë se pesha specifike e qytetarëve që deklarojnë se kanë dhënë ryshfet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, për të marrë shërbime nga zyrtarët publikë, mbetet e lartë (**59% e respondentëve**). Kjo përfaqëson një rritje me rreth 19 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2023, duke sinjalizuar një përkeqësim të situatës. Treguesi i presionit ka ndjekur të njëjtën prirje në rritje: **54% e të anketuarve pohuan se u është kërkuar ryshfet**, një nivel më i lartë se ai i vitit 2021. Këto të dhëna sugjerojnë se ekspozimi i qytetarëve ndaj presionit korruptiv të administratës mbetet përgjithësisht i lartë. Ndërkaq, është pozitiv fakti që **pesha specifike e qytetarëve që deklarojnë se kanë dhënë ryshfet në formë të hollash** (para të gatshme), dhuratash apo favoresh vetëm pasi iu janë kërkuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga zyrtarët publikë, **është dukshëm më e ulët në krahasim me CMS 2023** (26.5% në vitin 2025 kundrejt 44% në vitin 2023).

Veprimtaria e SPAK-ut në ndëshkimin e korrupsionit në nivelet e larta politike **ka rritur besimin e publikut në suksesin e luftës kundër korrupsionit në Shqipëri**. Shoqëria civile mbështet veprimtarinë e SPAK-ut, ofron ekspertizën e saj dhe mbetet e angazhuar në ndërgjegjësimin publik në luftën kundër korrupsionit.

Në aspektin normativ, pjesa më madhe e qytetarëve mbeten kundër korrupsionit. **69% e respondentëve** deklarojnë se nuk e konsiderojnë të pranueshëm që anëtarët e parlamentit, qeverisë apo zyrtarët e administratës publike të marrin dhurata, para ose nderime në këmbim të një shërbimi. Kjo përfaqëson një **rritje me 4 pikë përqindje** krahasuar me vitin 2023. Përkundrazi, vetëm **31% e qytetarëve** e konsiderojnë ryshfetin si të pranueshëm, kundrejt **35% në vitin 2023**, duke treguar një **rrënie të normalizimit shoqëror të korrupsionit**.

Mbështetur në rezultatet e vrojtimit të ACER, të dhënat e sondazhit të vitit 2025 tregojnë një **ndryshim të dukshëm pozitiv** në raport me vitet e mëparshme, ku vetëm **56% e të anketuarve identifikohen si të ndjeshëm ndaj korrupsionit**. Ndërkohë, **18% e qytetarëve** deklarojnë se janë plotësisht të pandjeshëm ndaj korrupsionit. Ky rezultat është veçanërisht domethënës duke pasur parasysh se, tradicionalisht, ryshfeti perceptohet si praktikë e zakonshme edhe për shërbime elementare.

për marrjen e shërbimeve publike, ndërsa kultura e pandëshkueshmërisë kishte qenë e ngulitur thellë prej dekadash.

Reforma në drejtësi në Shqipëri ka ulur perceptimin negativ ndaj hallkave të sistemit të drejtësisë, por problematike mbetet vonesa në marrjen e shërbimeve të lidhura me të, për shkak të numrit të kufizuar të personelit dhe volumit të madh të dosjeve të trashëguara. Në vlerësimin e perceptimeve të qytetarëve mbi nivelet e korrupsionit në grupe të ndryshme profesionale, CMS

2025 tregon zhvendosjen e kategorive të profesioneve të identifikuara si “më të korruptuara” në CMS 2023 pra, nga **gjyqtarët, doganierët, prokurorët publikë**, zyrtarët e gjykatave dhe liderët politikë drejt **zyrtarëve të taksave dhe pedagogëve universitarë**. Ndërsa grupet që perceptohen si më pak të korruptuara mbeten të njëjtat si në vitet e mëparshme (gazetarët dhe këshilltarët bashkiakë), duke ruajtur kështu një stabilitet në qëndrimet publike ndaj këtyre aktorëve.

Një element shumë i rëndësishëm në këtë studim është i pritshmërive për të ardhmen. Të dhënat e vitit 2025 tregojnë se qytetarët shfaqin nivela të larta pesimizmi: **77% e tyre besojnë se situata aktuale e korrupsionit do të mbetet e pandryshuar**, ndërsa vetëm **22% shpresojnë për një të ardhme me nivele më të ulëta korrupsioni**. Ky trend është në përputhje me gjetjet e viteve të mëparshme dhe nxjerr në pah një hendek të dukshëm mes qëndrimeve individuale dhe zhvillimeve institucionale. Ndërsa në nivel individual qytetarët po tregojnë një prirje gjithnjë e më të ulët për ta pranuar korrupsionin si normë shoqërore, veprimet institucionale ende perceptohen si të pamjaftueshme për të adresuar pritshmëritë dhe interesat e publikut.

Thellimi i reformave të ndërmarra në kuadrin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian pritet të frenojë korrupsionin në vend. Ky fenomen mbetet një kërcënim serioz për zhvillimin ekonomik e shoqëror të Shqipërisë, si dhe një nga shkaqet kryesore të dobësimit të demokracisë, përkeqësimit të llogaridhënies dhe shkeljes së të drejtave të njeriut. **Përparimi i Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit mbetet një përparësi kryesore dhe afatgjatë**, e cila kushtëzohet ndjeshëm nga angazhimi institucional i agjencive të tjera shtetërore, përveç SPAK-ut. Kjo është thelbësore edhe për të frenuar tendencat autoritariste në qeverisjen e vendit, për të ndaluar boshatisjen e tij dhe për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm. Në këtë kontekst, CMS 2025 nxjerrin në pah nevojën për rritjen e angazhimit të organizatave të shoqërisë civile dhe ndërmarrjen e veprimeve të përbashkëta konkrete për të adresuar sofistikimin në rritje të korrupsionit në Shqipëri.

2. Hyrje

Korrupsioni mbetet një nga sfidat më të mëdha për shoqëritë moderne, duke ndikuar negativisht në qeverisje, zhvillim ekonomik dhe kohezion social. Ai përkufizohet shpesh si **abuzimi me pushtetin e dhënë për përfitime private**, por në praktikë shfaqet në forma shumë më komplekse, që variojnë nga ryshfetet e vogla deri tek kapja e shtetit dhe deformimi i politikave publike. Raportet ndërkombëtare të Transparency International, Bankës Botërore dhe Komisionit European tregojnë se korrupsioni nuk është vetëm një problem moral apo ligjor, por një fenomen i ndërlikuar që minon konkurrencën e ndershme, pengon investimet dhe gërryen besimin e qytetarëve tek institucionet.

Natyra e tij është strukturore dhe e shumëanshme. Korrupsioni shpesh lidhet me dobësinë e institucioneve, mungesën e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe mungesën e mekanizmave të fortë të “check and balance”. Në vende me institucione të brishta, ai shndërrohet në një rreth vicioz: sa më i përhapur të jetë, aq më shumë gërryen themelet e sundimit të ligjit, duke bërë të vështirë ndarjen mes interesit publik dhe atij privat. Për këtë arsye, matja dhe monitorimi i korrupsionit nuk është një proces i thjeshtë, por kërkon kombinimin e të dhënave sasiore me analiza të perceptimeve, sjelljeve dhe praktikave sociale që e shoqërojnë atë.

Në nivel global, përpjekjet për të luftuar korrupsionin kanë marrë forma të ndryshme: nga strategjitë kombëtare anti-korrupsion dhe reformat institucionale, deri tek mekanizmat ndërkombëtarë të monitorimit dhe presionit politik. Megjithatë, rezultatet shpesh kanë qenë të pabarabarta. Përvoja tregon se sukseset më të dukshme arrihen aty ku **lufta kundër korrupsionit nuk mbetet vetëm në kuadër ligjor**, por shndërrohet në një proces gjithëpërfshirës që angazhon shoqërinë civile, median, biznesin dhe vetë qytetarët. Kjo tregon se korrupsioni nuk është thjesht një çështje ndëshkimesh, por një fenomen i cili kërkon transformim kulturor dhe institucional.

Në këtë kontekst, Shqipëria përbën një rast studimi veçanërisht domethënës. Raportet e viteve të fundit nga Komisioni European theksojnë se korrupsioni mbetet një shqetësim madhor për qytetarët shqiptarë dhe një nga pengesat kryesore për procesin e integritetit european. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International e rendit Shqipërinë ndër vendet më të prekura në rajon, ndërkohë që Barometri i Ballkanit i Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal tregon se perceptimi i qytetarëve shqiptarë për përhapjen e korrupsionit është më i larti në Ballkanin Perëndimor. Këto gjetje dëshmojnë jo vetëm përmasat e fenomenit, por edhe rolin e tij si faktor që ndikon në besimin publik dhe në mënyrën se si qytetarët e perceptojnë demokracinë funksionale.

Megjithëse reformat e ndërmarra, si Reforma në Drejtësi dhe krijimi i institucioneve të reja si SPAK dhe Byroja Kombëtare e Hetimit, kanë krijuar pritshmëri të larta, efektet konkrete janë ende të kufizuara në perceptimin publik. Shumë qytetarë vijnë të besojnë se korrupsioni është i përhapur në nivelet më të larta të politikës dhe administratës publike, duke ushqyer ndjenjën e **“kulturës së pandëshkueshmërisë”**. Kjo gjendje e bën të domosdoshme monitorimin sistematik dhe të paanshëm të fenomenit, si dhe ndërtimin e politikave të bazuara në prova dhe në matje të sakta, të cilat mund të ndihmojnë në thyerjen e këtij cikli.

3. Metodologjia e Monitorimit të Korrupsionit (CMS)

Që prej vitit 2001, SELDI ka zbatuar Sistemin e Monitorimit të Korrupsionit (CMS), një instrument unik për matjen dhe analizimin e korrupsionit në rajon, ku përfshihet edhe Shqipëria. Metodologjia e zhvilluar nga Qendra për Studimin e Demokracisë në Bullgari është njohur nga Bashkimi Europian si një nga qasjet më efektive për monitorimin e korrupsionit. Risia e saj qëndron në fokusin tek matja e përvojave reale të qytetarëve si “viktima” të praktikave korruptive, duke plotësuar kështu qasjet tradicionale të bazuara vetëm mbi perceptim.

CMS siguron krahasueshmëri ndërmjet shteteve dhe mat prirjet afatgjata të korrupsionit. Ai kombinon tregues mbi përfshirjen faktike të individëve në transaksione korruptive, perceptimet e tyre për sjelljen e zyrtarëve, si dhe qëndrimet dhe gatishmërinë e qytetarëve për të kundërshtuar praktikën korruptive. Për këtë qëllim përdoren indikatorë të testuar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, të cilët garantojnë besueshmëri dhe qëndrueshmëri metodologjike.

Në Shqipëri, për gjenerimin e këtyre treguesve, është realizuar një anketim kombëtar me një kampion përfaqësues prej 1,000 qytetarësh. Shpërndarja e kampionit dhe numri i intervistave janë përcaktuar në përpjesëtim me popullsinë aktuale të secilës zonë të vendit, duke siguruar një përfaqësim sa më të afërt me strukturën e popullsisë shqiptare. Ky kampion mundëson përgjithësimin e rezultateve për të gjithë popullsinë. Anketimi është zhvilluar në intervale të rregullta, duke ndjekur të njëjtën metodologji, në vitet 2001, 2002, 2014, 2016, 2019, 2021, 2023 dhe 2025, gjë e cila bën të mundur krahasimin ndërkohor të të dhënave dhe identifikimin e tendencave kryesore.

Metodologjia e CMS (e ilustruar në figurën 1) është e ndërtuar mbi një grup indikatorësh kryesorë, të cilët ndahen në dy fusha themelore: përvoja direkte me korrupsionin administrativ dhe sjellja e qytetarëve ndaj korrupsionit.¹

1. Përvoja me korrupsionin administrativ

Ky dimension mat kontaktin real të qytetarëve me praktikën korruptive dhe përfshin dy tregues:

- **Presioni i korrupsionit** – situatat kur një zyrtar publik i kërkon qytetarit pagesë joformale, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, qoftë duke lënë të kuptohet se zgjidhja e problemit varet nga një shpërblim i tillë.
- **Përfshirja në korrupsion** – rastet kur qytetarët kanë pranuar të kryejnë pagesa joformale. Ky tregues ndan të anketuarit në dy kategori: ata që kanë paguar të paktën një herë gjatë vitit të fundit dhe ata që nuk kanë patur asnjë përvojë të tillë.

2. Sjellja ndaj korrupsionit


Kjo fushë analizon qëndrimet, njohuritë dhe reagimet e qytetarëve përballë korrupsionit, përmes tre treguesve:

- **Njohja e korrupsionit** – mat aftësinë e qytetarëve për të identifikuar praktikën korruptive, duke i kategorizuar ata në nivele të larta, të moderuara ose të ulëta njohjeje.

¹ CMS është e shpjeguar me detaje më specifike në [CMS Methodology - SELDI](#)

- **Pranueshmëria e korrupsionit** – vlerëson në ç'masë qytetarët e shohin si të justifikueshme marrjen e dhuratave, parave apo favoreve nga zyrtarët publikë në këmbim të shërbimeve.
- **Ndjeshmëria ndaj korrupsionit** – analizon reagimin e qytetarëve përballë situatave hipotetike:
 - nëse, si zyrtarë publikë, ata do të pranonin ose refuzonin një ryshfet të ofruar, dhe
 - nëse, si qytetarë, do të jepnin ose jo ryshfet kur u kërkohet për të zgjidhur një problem të rëndësishëm. Refuzimi i ryshfetit në të dy rastet tregon mungesë të plotë tolerance ndaj korrupsionit; pranimi i tij në të dyja rastet shfaq ndjeshmëri të lartë, ndërsa një reagim i kombinuar në njëren situatë por jo në tjetrën përshkruan një sjellje të përzier.

Figura 1. Indikatorët e vlerësimit të korrupsionit nga Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit



Perceptimet e qytetarëve mbi korrupsionin maten përmes tre indikatorëve kryesorë:

- **Mundësia e presionit të korrupsionit** – mat pritshmëritë e qytetarëve për rrezikun që të përballen me kërkesa për pagesa joformale gjatë bashkëveprimit me administratën publike. Ky tregues pasqyron perceptimin mbi mjedisin e përgjithshëm korruptues.
- **Realizueshmëria e politikave kundër korrupsionit** – vlerëson mendimet e qytetarëve për efektivitetin e masave politike dhe qeveritare kundër korrupsionit. Ky indikator shërben gjithashtu për të matur mbështetjen e mundshme publike ndaj politikave anti-korrupsion.
- **Korruptimi i zyrtarëve publikë** – mat perceptimet e qytetarëve për shkallën e korruptimit të grupeve të ndryshme të zyrtarëve. Ky tregues ndihmon të identifikohen sektorët dhe institucionet që perceptohen si më të prekura nga korrupsioni.

Përveç këtyre elementeve, analiza përfshin edhe një grup pyetjesh me karakter shoqëror e ekonomik, të cilat shërbejnë për të plotësuar panoramën mbi realitetin e perceptuar nga qytetarët. Këto dimensione shtesë ndihmojnë që gjetjet të pasqyrojnë më mirë kontekstin e përditshëm social, duke e bërë këtë vlerësim më gjithëpërfshirës dhe të krahasueshëm me studime të tjera ekzistuese.

4. Nivelet e korrupsionit në Shqipëri

4.1 Dënimet në lidhje me korrupsionin

Në vitin 2024, Shqipëria shënoi një përmirësim të ndjeshëm në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit (CPI)², duke arritur në 42 pikë. Ky rezultat vjen pas një periudhe të gjatë pesë vjeçare, kur niveli i perceptuar i korrupsionit ka mbetur i qëndrueshëm në intervalin 36–37 pikë. Analizat krahasuese zakonisht realizohen në raport me vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat karakterizohen nga profile të ngjashme ekonomike dhe ndajnë të njëjtin objektiv strategjik të integritimit europian. Në këtë kontekst, **Shqipëria renditet katër pikë mbi mesataren rajonale** prej 38 pikësh. Megjithatë, pavarësisht këtij progresi, hendeku me mesataren e Bashkimit Europian mbetet i konsiderueshëm, pasi kjo e fundit pozicionohet aktualisht në rreth 64 pikë.

Raportet vjetore të Ministrisë së Drejtësisë (2004–2024)³ tregojnë se numri i personave të dënuar për shpërdorim detyre në institucionet publike ka pësuar një rënie të ndjeshme pas vitit 2017, duke arritur nivele shumë të ulëta gjatë tre viteve të fundit. Të dhënat e vitit 2024 konfirmojnë këtë tendencë, ku vetëm 12 persona janë dënuar për këtë veprë penale nga Gjykatat e Shkallës së Parë. Në krahasim, viti 2016 përfaqëson kulmin historik, me 179 persona të dënuar për shpërdorim detyre.

Në një vështrim sipërfaqësor, kjo ulje mund të interpretohet si përmirësim i kuadrit institucional dhe reduktim i rasteve të korrupsionit në administratën publike. Megjithatë, një analizë më e thelluar sugjeron se rënia e numrit të dënimeve nuk lidhet domosdoshmërisht me një nivel më të ulët korrupsioni, por shpesh reflekton ndryshime në kualifikimin juridik të veprës penale. Pas reformës në drejtësi dhe krijimit të Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), **ka ndodhur një zhvendosje e qasjes institucionale**. SPAK ka orientuar fokusin drejt hetimeve më të thelluara dhe ndjekjes së rasteve të korrupsionit në nivele të larta, duke u distancuar nga ndjekja e rasteve më të thjeshta. Për këto të fundit, shpesh aplikohen masa alternative si pezullimet, sanksionet disiplinore ose masat administrative, të cilat nuk përfundojnë me dënim penal.

Sipas Raportit Vjetor të SPAK për vitin 2024, janë regjistruar gjithsej 33 ish-zyrtarë të lartë nën hetim, dy prej të cilëve të përfshirë në dy procedime të ndryshme secili. Nga ky grup, 19 persona janë dërguar për gjykim, duke përbërë 52.9% të rasteve, ndërkohë që për 10 funksionarë të lartë publik janë dhënë vendime të formës së prerë. Këto tregues ilustrojnë një zhvendosje të qartë të fokusit institucional dhe intensifikimin e përpjekjeve për adresimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar në nivelet më të larta të administratës publike.⁴

Në totalin e çështjeve të dënimeve për korrupsion përfshihen pesë kategori kryesore:

- Korrupsioni në sektorin publik⁵,
- Konflikti i interesave dhe deklarimi i pasurisë,
- Korrupsioni i nivelit të lartë,

² [Corruption Perceptions Index 2024 - Transparency.org](https://www.transparency.org/cpi)

³ Ministria e Drejtësisë, vjetarit statistikor: <https://www.drejtesia.gov.al/statistika/>

⁴ <https://spak.gov.al/wp-content/uploads/2025/04/Raporti-vjetor-SPAK-2024.pdf>


⁵ Tek kjo kategori përfshihet edhe vepra penale e shpërdorimit të detyrës (neni 248).

- Korrupsioni në sistemin gjyqësor,
- Korrupsioni në sektorin privat dhe Falsifikimi⁶

Numri i të dënuarve për korrupsion në total është paraqitur në figurën e mëposhtëme me ngjyrë blu. Gjatë viteve 2015, 2016 dhe 2017, numri i të dënuarve pothuajse është trefishuar në krahasim me vitet paraardhëse, duke reflektuar një intensifikim të veprimtarisë gjyqësore dhe ndoshta një vullnet politik më të fortë për të adresuar këtë fenomen. Megjithatë, pas vitit 2018, ky numër ka shënuar një rënie të ndjeshme dhe **deri në vitin 2024 është stabilizuar në nivele dukshëm më të ulëta.**

Ky ndryshim nuk është thjesht një tregues sasior, por ngre pyetje mbi mënyrën se si funksionojnë institucionet dhe si klasifikohen veprat korruptive. Përmirësimi i sundimit të ligjit dhe reformat në drejtësi mund të kenë kontribuar në uljen e rasteve, por një faktor po aq i rëndësishëm është edhe zhvendosja e fokusit institucional drejt rasteve më të rënda dhe më të ndërlikuara.⁷ Pas vitit 2018, rënia e numrit të të dënuarve për korrupsion përkon me hyrjen në fuqi të institucioneve të reja të reformës në drejtësi. Këto institucione kanë orientuar prioritetet e ndjekjes penale drejt rasteve me profil të lartë, duke e zhvendosur fokusin nga korrupsioni i vogël administrativ te zyrtarët e lartë dhe fenomenet e lidhura me kapjen e shtetit. Ky riorientim ka prodhuar një numër më të vogël vendimesh gjyqësore, por të një peshe më të madhe politike dhe shoqërore, gjë që shpjegon pse ulja e statistikave nuk duhet interpretuar si reduktim i fenomenit, por si pasqyrim i një ndryshimi thelbësor në qasjen institucionale ndaj korrupsionit.⁸ Në këtë kuadër, rënia e numrit të dënimeve nuk duhet interpretuar në mënyrë lineare si reduktim i fenomenit të korrupsionit, por më shumë si një **pasqyrim i ndryshimeve në arkitekturën institucionale**, prioritetet e politikës penale dhe orientimin e strategjive kundër korrupsionit në Shqipëri.

Figura 2. Numri i personave të dënuar për korrupsion dhe për shpërdorim detyre (2004-2024)



Burimi: Ministria e Drejtësisë (2024)⁹

Arsyeja kryesore që ka ndikuar në ecurinë e hetimeve dhe dënimeve për çështjet e korrupsionit gjatë viteve lidhet ngushtë me procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Në vitin 2014, kur Shqipëria mori statusin e vendit kandidat, Këshilli i Europës përcaktoi pesë prioritetet

⁶ Për më tepër specifikime të neneve ligjore: “Vjetari Statistikor 2024” (fq. 92-94) - [Vjetari-Statistikor-2024.pdf](#)

⁷ https://enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en

⁸ <https://spak.gov.al/wp-content/uploads/2025/04/Raporti-vjetor-SPAK-2024.pdf>

⁹ Për numrin total të çështjeve para vitit 2009 nuk mund të gjenim informacion.

kryesore që vendi duhej të përmbushte përpara fillimit të negociatave për anëtarësim. Ndër këto prioritetet, sundimi i ligjit dhe **lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar u renditën si çështje kyçe**. Në vitin 2016, bazuar në arritjet në këto fusha, Komisioni Europian i propozoi për herë të parë Këshillit të fillonte negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë, me kusht të një progresi konkret në zbatimin e reformës në drejtësi, veçanërisht procesin e “vettingut” të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe përpjekjet kundër korrupsionit. Për këtë arsye, institucionet shqiptare gjatë këtyre viteve treguan mobilizim dhe angazhim të dukshëm në luftën kundër korrupsionit dhe në implementimin e reformës në drejtësi, duke synuar rezultate konkrete për të përparuar në procesin integruar.

Gjatë periudhës 2017–2019, procesi i vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve (Vetting-u) ndikoi në rritjen e çështjeve që lidhen me konfliktin e interesave dhe deklarimin e pasurisë, duke sjellë një rritje të numrit të dënimeve. Ky progres i reformës kontribuoi gjithashtu në hapjen e negociatave për integrimin në BE në mars të vitit 2020, duke shtuar presionin ndaj institucioneve për të demonstruar rezultate konkrete. Pas procesit të vettingut, mbi 300 gjyqtarë dhe prokurorë u shkarkuan¹⁰, një hap i jashtëzakonshëm që jo vetëm eliminon pjesë të konsiderueshme të korrupsionit në sistemin gjyqësor, por edhe dëshmon se kapacitetet institucionale janë funksionale kur përdoren në mënyrë efektive.

Synimi aktual i Shqipërisë për anëtarësim në BE deri në vitin 2030 duket më realist, duke ofruar një perspektivë pozitive se korrupsioni mund të reduktohet gradualisht. Ky objektivi integruar vepron si një “dritë jeshile”, duke rritur besimin në efektivitetin e reformave dhe përkushtimin institucional për një administratë më transparente dhe përgjegjëse.

¹⁰ [Mbyllet procesi i vettingut, mbi 300 gjyqtarë e prokurorë të shkarkuar në 7 vjet - Kronika](#)

5. Rezultatet e Sistemit të Monitorimit të Korrupsionit 2025

5.1 Përvoja me korrupsionin

5.1.1 Presioni i korrupsionit dhe përfshirja në korrupsion

Përvoja e qytetarëve me korrupsionin lidhet ngushtë me dy indikatorë kryesorë të korrupsionit administrativ: **përfshirja**, që lidhet me dhënien e ryshfetit, dhe **presioni**, që nënkupton kërkesën për ryshfet. Të dhënat historike tregojnë se gjatë viteve ka pasur luhatje të konsiderueshme në këto tregues.


Sipas të dhënave për vitin 2025, **59.0% e qytetarëve pranojnë se kanë dhënë ryshfet**, duke shënuar një rritje prej rreth 19 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2023 (40.0%). Treguesi i presionit gjithashtu është rritur, me 54% të të pyeturve që deklarojnë se u është kërkuar ryshfet, megjithëse kjo shifër është vetëm pak më e lartë se në vitin 2023 (52.1%).

Një element i rëndësishëm është **ngushtimi i diferencës midis presionit dhe përfshirjes**. Ndërsa gjatë viteve të mëparshme, për shembull në 2023, presioni (52.1%) ishte dukshëm më i lartë se përfshirja (40.0%), në 2025 qytetarët po marrin pjesë më masivisht në praktikatat korruptive edhe kur presioni nuk është më i lartë. Kjo tregon **një normalizim gradual të ryshfetit si mjet për të përsheptuar ose zgjidhur çështje administrative**.

Analiza e trendit afatgjatë tregon se vitet e zgjedhjeve parlamentare lidhen me rritje të korrupsionit. Për shembull, vitet 2017 dhe 2021 shënuan rritje të dukshme të të dy indikatorëve, duke reflektuar përdorimin më të madh të burimeve publike dhe përpjekjet për të ushtruar ndikim tek qytetarët për arsye elektorale. Viti 2025 vazhdon këtë trend, duke u afruar me nivelet e larta të vitit 2001 (përfshirja 68.3%, presioni 72.8%). Ky fakt tregon se progresi kundër korrupsionit nuk është i qëndrueshëm dhe mbetet i ndjeshëm ndaj zhvillimeve politike dhe elektorale.

Për më tepër, sipas platformës *Corruption Risk*, Shqipëria ende përballet me nivele të larta rreziku për korrupsion. Kjo lidhet kryesisht me shpërndarjen diskrecionare të fondeve publike dhe me mungesën e mbikëqyrjes së fortë në prokurime dhe financa publike. Ky fakt tregon se edhe pse numri i dënimeve ka rënë, kushtet që e favorizojnë korrupsionin vazhdojnë të jenë të pranishme dhe ndikojnë në pranimin e ryshfetit si një praktikë të zakonshme në marrëdhëniet me administratën.¹¹

¹¹ <https://corruptionrisk.org/country/?country=ALB&utm>

Figura 3. Presioni i korrupsionit dhe përfshirja në korrupsion

5.1.2 Rezistenca ndaj presionit të korrupsionit


Dhënia e rryshfetit vazhdon të jetë forma më e dukshme e korrupsionit mes qytetarëve dhe zyrtarëve publikë, por mënyra se si ndodh kjo ka ndryshuar këtë vit. Të dhënat tregojnë se presioni i drejtpërdrejtë nga zyrtarët, që detyron qytetarët të japin rryshfet për të marrë shërbimin e kërkuar, **ka pësuar një ulje të ndjeshme krahasuar me vitin 2023.**

Rreth 26,5% e respondentëve konfirmojnë se kanë dhënë një nga format e rryshfetit, si para, dhuratë apo nder, vetëm kur zyrtari ua ka kërkuar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kjo përqindje përfaqëson një ulje të ndjeshme krahasuar me vitin 2023, kur niveli ishte rreth 44%. Një arsye kryesore për këtë rënie lidhet me faktin se qytetarët po orientohen gjithnjë e më shumë drejt mënyrave alternative për të zgjidhur çështjet e tyre, pa dhënë rryshfet dhe pa marrë pjesë në praktika korruptive. Kjo tendencë reflektohet edhe nga fakti që rreth 50% e të pyeturve shprehën se **do të preferonin të ndiqnin rrugën ligjore**, nëse kjo do të ishte e mundur.

Nga ana tjetër, në rastet kur zyrtari nuk ka kërkuar rryshfet dhe qytetari nuk është ndjerë i presionuar, vetëm 1,5% kanë dhënë rryshfet. Kjo sjellje lidhet me nivelin e ulët të besimit tek mekanizmat e raportimit dhe politikat antikorrupsion të ndërmarra nga qeveria, si dhe me perceptimin se nuk ka alternativë tjetër për të marrë shërbimin e kërkuar.

Ky vit tregon një ulje të dukshme krahasuar me vitet e mëparshme, duke sugjeruar se nëse mekanizmat institucional funksionojnë si duhet, shumica e qytetarëve nuk do të përfshihen në korrupsion. Në shumicën e rasteve, është presioni nga zyrtarët ai që i detyron qytetarët të marrin pjesë në praktikat korruptive.

Figura 4. Rezistenca ndaj presionit të korrupsionit.



5.2 Sjelljet ndaj Korrupsionit


Në kuadër të anketës, qytetarët u pyetën nëse e konsiderojnë të pranueshme që anëtarët e parlamentit, qeverisë apo zyrtarët në ministri dhe bashki të marrin dhurata, para, nder ose dreka falas në këmbim të zgjidhjes së një çështjeje personale të qytetarit.

Rezultatet tregojnë se, ndonëse shumica e qytetarëve (69%) e konsiderojnë ryshfetin të papranueshëm, një pjesë e konsiderueshme e shoqërisë vijon ta shohë atë si një praktikë të pranueshme. Megjithëse kjo përqindje ka rënë me 4 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2023, fakti që 31% e respondentëve ende e justifikojnë ryshfetin tregon se korrupsioni mbetet i normalizuar në një segment të rëndësishëm të shoqërisë.

Ky normalizim pasqyron një realitet ku, për shumë qytetarë, ryshfeti perceptohet ende si një mjet alternativ për zgjidhjen e problemeve, veçanërisht në kontekste ku besimi te institucionet është i ulët dhe procedurat ligjore konsiderohen joefikase. Kjo tregon se ndryshimet në qëndrime janë të ngadalta dhe të brishta, dhe se toleranca ndaj praktikave korruptive vazhdon të jetë e rrënjësuar në përditshmërinë institucionale dhe sociale.

Gjithsesi, ky rezultat është i rëndësishëm, sepse tregon një hap drejt meritokracisë dhe funksionimit më të mirë të institucioneve. Sa më shumë që qytetarët të refuzojnë korrupsionin dhe të kërkojnë zgjidhje ligjore për problemet e tyre, aq më i fortë bëhet themeli për një shoqëri të drejtë dhe të qëndrueshme, duke u afruar gradualisht me standardet europiane dhe duke rritur besimin tek institucionet publike.

Figura 5. Pranimi i korrupsionit



Për të vlerësuar ndjeshmërinë e qytetarëve ndaj korrupsionit, ata janë pyetur mbi sjelljen e tyre në dy situata hipotetike:

- Nëse ata do të ishin në pozicionin e një zyrtari publik dhe dikush u ofronte ryshfet, a do ta pranonin atë?
- Nëse një zyrtar publik do t'u kërkonte drejtpërdrejt ryshfet për të marrë një shërbim, a do të ishin të gatshëm ta jepnin?

Përgjigjet e dhëna lejuan kategorizimin e respondentëve në tre grupe:


- **Të ndjeshëm ndaj korrupsionit:** ata që pranojnë se do të jepnin ose do të merrnin ryshfet.
- **Të pandjeshëm ndaj korrupsionit:** ata që deklarojnë se nuk do të jepnin dhe as nuk do të merrnin ryshfet.
- **Sjellje të miksuar:** ata që do të jepnin ryshfet por nuk do të merrnin, ose e kundërta.

Nga të dhënat e përgjigjeve të respondentëve (Figura 6) rezulton se viti 2025 përfaqëson një vazhdimësi të trendit të vërejtur në vitin 2023, **pa shënuar ndryshime të forta strukturore në qëndrimet ndaj korrupsionit**. 56% e të anketuarve klasifikohen si të ndjeshëm ndaj korrupsionit, duke reflektuar një qëndrim kritik dhe refuzues ndaj praktikave korruptive, në përputhje me tendencën e konsolidimit gradual të këtij grupi në vitet e fundit.

Në të njëjtën kohë, 18% e respondentëve mbeten të pandjeshëm ndaj korrupsionit, çka tregon se një segment i shoqërisë vazhdon të shfaqë tolerancë ose indiferencë ndaj këtyre praktikave. Megjithatë kjo përqindje nuk paraqet rritje, prania e saj sinjalizon një problem strukturor që vijon të jetë i qëndrueshëm në kohë.

Sjelljet me karakter të miksuar përbëjnë 26% të të anketuarve, duke konfirmuar ekzistencën e një grupi të ndërmjetëm me qëndrime ambivalente, i cili lëviz mes refuzimit dhe justifikimit të korrupsionit në varësi të rrethanave. Kjo kategori, e cila mbetet relativisht e qëndrueshme krahasuar me vitin 2023, sugjeron se normalizimi i praktikave informale nuk është kapërcyer plotësisht dhe se ndërhyrjet për ndryshimin e qëndrimeve kërkojnë kohë dhe konsistencë.

Figura 6. Ndjeshmëria ndaj korrupsionit



5.3 Perceptimet mbi Korrupsionin

Analiza e mëposhtme bazohet në vlerësimin e drejtpërdrejtë të qytetarëve mbi nivelet e korrupsionit në grupe të ndryshme profesionale. Qytetarët kanë dhënë opinionin e tyre për të identifikuar se cilat nga grupet e listuara shihen si më të prekura nga korrupsioni. Nga të dhënat rezultojnë se perceptimi i lidhjes së korrupsionit me individët përgjegjës është ulur ndjeshëm krahasuar me vitet e mëparshme. Në një shkallë prej 4 pikësh, ku 4 simbolizon korrupsion maksimal, kategoritë më të larta kanë arritur maksimumin prej vetëm 2.6 pikësh.

Megjithatë, ky vit shënon edhe një ndryshim të dukshëm në krahasim me trendin e mëparshëm. Në vitet e kaluara, qytetarët i identifikonin si më të korruptuar **gjuqtarët, doganierët, prokurorët publikë, zyrtarët e gjykatave dhe liderët politikë**. Këtë vit, dy nga këto kategori të fundit janë zëvendësuar nga **zyrtarët e taksave dhe pedagogët e universiteteve**.¹²

Ky ndryshim është i rëndësishëm dhe përbën një fenomen të veçantë, pasi pedagogët janë perceptuar si një nga grupet më pak të prekura nga korrupsioni në vitet paraardhëse. Në vitet e fundit, disa skandale të raportuara në fushën e arsimit kanë ndikuar në perceptimin publik të pedagogëve si një grup më të prekshëm nga korrupsioni. Raste të tilla përfshijnë arrestimin e pedagogëve të Universitetit të Elbasanit¹³ për kërkim ryshfeti nga studentët, hetimet e SPAK-ut për abuzime me tenderat në Universitetin Bujqësor të Tiranës¹⁴ dhe shkeljet e procedurave në Shkollën e Magjistraturës. Këto ngjarje nxjerrin në pah praktika korruptive brenda komunitetit akademik dhe tregojnë ndjeshmërinë e qytetarëve ndaj informacionit, duke ndikuar në


¹² Sipas analizave të Qendrës A.L.T.R.I. gjyqtarët dhe prokurorët vazhdojnë të renditen ndër grupet me nivelin më të lartë të korrupsionit. [Analiza-mbi-hetimin-administrativ-te-korrupsionit-2024.pdf](#)

¹³ <https://shqiptarja.com/lajm/elbasan-shoqerohen-ne-polici-disa-pedagog-te-universitetit-aleksander-xhuvani>

¹⁴ <https://shqiptarja.com/lajm/spak-mbyll-hetimet-per-abuzim-me-tenderat-te-universiteti-bujqesor-i-tiranes-merr-28-te-pandehur-dosja-drejt-gjikko>

perceptimin publik ndaj pedagogëve. Kjo tregon se perceptimi publik mund të ndryshojë shpejt në varësi të ngjarjeve të fundit dhe të transparencës së raportimit.

Figura 7. Perceptimet e korrupsionit për zyrtarët publik – më të korruptuarit



Grupet që qytetarët i perceptojnë si më pak të korrumpuar mbeten **gazetarët dhe këshilltarët bashkiak**, të cilët qëndrojnë në të njëjtën kategori si vitet e kaluara. Megjithatë, këtë vit ky grup përfshin edhe dy kategori të reja që zëvendësojnë mësuesit dhe pedagogët, konkretisht **bankierët dhe drejtuesit e organizatave joqeveritare**. Siç shihet nga figura, këto grupe kanë pësuar një ulje të ndjeshme të pikëve krahasuar me vitet e mëparshme, duke shënuar një vlerë prej 2,4 deri 2,5 pikësh nga 4 të mundshme.

Figura 8. Perceptimet e korrupsionit për zyrtarët publik – më pak të korrumpuarit





Figura 9 më poshtë ofron një pasqyrë të qartë të ndryshimeve në perceptimin e korrupsionit midis grupeve të ndryshme profesionale, nga një vit në tjetrin. Për shumicën e grupeve, indikatorët tregojnë një ulje të perceptimit të korrupsionit krahasuar me vitin 2023.

Një përjashtim përbëjnë pedagogët, mësuesit dhe gazetarët, të cilët shënojnë një rritje të perceptimit publik për përfshirjen e tyre në korrupsion. Ndër këta, **mësuesit shënojnë rritjen më të dukshme, me 0,46 pikë**. Ky rezultat nënvizon rëndësinë e monitorimit të vazhdueshëm të perceptimit publik dhe ndikimin që ngjarjet ose skandalet e fundit mund të kenë në vlerësimin qytetar ndaj grupeve profesionale.

Këto të dhëna konfirmohen nga sondazhi i realizuar nga Instituti Ndërkombëtar Republikan (IRI) në Shqipëri ku qytetarët shprehin besim të lartë në disa institucione, ndërsa të tjera përballen me nivel të ulët besimi. Në krye të listës së institucioneve më të besuara është Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), me 76% të qytetarëve që shprehin besim në këtë institucion. Ky besim i lartë pasqyron pritshmëritë pozitive të qytetarëve që përkojnë me vlerësimin tone aktual. Nga ana tjetër, disa institucione të tjera shënojnë nivele të ulëta besimi. Për shembull, partitë politike dhe Kuvendi i Shqipërisë janë renditur ndër institucionet më të pakënaqura, me besim të ulët nga qytetarët. Ky trend pasqyron shqetësimet e qytetarëve për lidhjet e mundshme të këtyre institucioneve me korrupsionin dhe interesat personale.¹⁵

Figura 9. Ndryshimi i perceptimit mbi korrupsionin mbi zyrtarët publikë (2023-2025)



¹⁵ <https://www.iri.org/resources/national-survey-of-albania-oct-nov-2024/?utm>


Për të vijuar me analizën e korrupsionit, ky seksion fokusohet në shkallën e mundësisë së ndodhjes së korrupsionit. Respondentët janë pyetur të vlerësojnë sa gjasa ka që ata të përdorin një nga format e ryshfetit, si dhënia e parave, dhurata apo nder për një zyrtar publik.

Duke u bazuar në përgjigjet e tyre – “ka gjasa”, “ka shumë gjasa”, “nuk ka gjasa” dhe “nuk ka aspak gjasa” – mund të analizojmë probabilitetin e përfshirjes në praktikën korruptive. Siç tregohet edhe nga Figura 10, **këtë vit është regjistruar një rritje e rëndësishme** e mundësisë për korrupsion me 14% krahasuar me vitin 2023 (nga 67% në 2023, në 81% në 2025).

Një trend paralel është ulja e numrit të respondentëve që nuk konsiderojnë të përdorin ryshfet për shërbime të nevojshme, **nga 33% në 2023 në 19% në 2025**, një tregues i rritjes së mundësisë për presion korrupsioni.

Rritja e probabilitetit të përdorimit të ryshfetit dhe ulja e besimit se shërbimet mund të merren pa përfshirje korruptive tregojnë nevojën për një kuadër të forcuar institucional.

Figura 10. Perceptimet mbi mundësinë për korrupsion (%)




E rëndësishme për vlerësimin e korrupsionit është edhe perceptimi i qytetarëve mbi të ardhmen. Duke analizuar trendet aktuale, individët mund të krijojnë pritshmëri dhe idetë e tyre se si do të evoluojë kjo dukuri. Në këtë kontekst, ne i kemi pyetur qytetarët se si mendojnë se do të zhvillohet situata e korrupsionit në Shqipëri: a do të reduktohet ndjeshëm, apo do të mbetet në nivelet aktuale? Kjo pyetje shërben edhe si një indikator i efektivitetit të politikave antikorrupsion deri në këtë moment.

Rezultatet tregojnë se qytetarët mbeten mjaft pesimistë për të ardhmen: **77% besojnë se situata aktuale do të vazhdojë**, ndërsa vetëm **22% shpresojnë në një të ardhme me nivele të ulëta korrupsioni**. Ky trend përkon me vlerësimet e viteve të mëparshme dhe tregon një hendek mes sjelljes individuale të qytetarëve, e cila po përmirësohet, dhe veprimeve institucionale, të cilat ende nuk duket se adresojnë plotësisht pritshmëritë dhe interesat e qytetarëve.

Ky perceptim konfirmohet edhe nga studimi i kryer nga Instituti për Zhvillim, Kërkim dhe Alternativa (IDRA) në gusht 2024, mbi 91% e qytetarëve shqiptarë e perceptojnë korrupsionin si një problem serioz në vend. Një nga gjetjet kryesore të këtij studimi është se qytetarët e

perceptojnë korrupsionin si një dukuri të rrënjosur dhe të vështirë për t'u eliminuar. Ata identifikojnë si faktorë kontribues kryesorë pagat e ulëta dhe zbatimin e dobët të ligjit. Këto shqetësime janë të lidhura ngushtë me perceptimin e qytetarëve për të ardhmen e korrupsionit në Shqipëri.¹⁶

Figura 11. Perceptimet mbi realizueshmërinë e politikave kundër korrupsionit (%)



5.4 Shtrirja e korrupsionit

Rezultatet e CMS janë mbledhur në të 12 qarqet administrative të Shqipërisë, duke respektuar peshën që secili qark ka në totalin e popullsisë. Ky raport, ndonëse paraqet një indeks të përgjithshëm kombëtar mbi korrupsionin, ofron gjithashtu të dhëna të detajuara në nivel rajonal. Analiza tregon se qarqet qendrore – si Tirana, Durrësi, Fieri dhe Elbasani – shfaqin nivele më të ulëta dhe më të qëndrueshme të perceptimit të korrupsionit, **me një mesatare prej 2,3 pikësh nga 4**. Ndërkohë, qarqet periferike regjistrojnë perceptime dukshëm më të larta duke kalur 3 pikë nga 4 të mundshme.

Ky rezultat bie ndesh me pritshmërinë tradicionale sipas së cilës korrupsioni duhet të jetë më i lartë në qendër, aty ku qarkullojnë fondet publike dhe merren vendimet politike. Përkundrazi, të dhënat sugjerojnë se **masat antikorrupsion kanë prodhuar efekte më të dukshme në zonat qendrore**, ku institucionet janë më të konsoliduara, mekanizmat e kontrollit dhe transparencës më të fortë, dhe monitorimi nga media e shoqëria civile më i pranishëm. Ndërkohë, në zonat periferike ligjit i është më e vështirë të garantojë zbatim të njëtrajtshëm për shkak të kapaciteteve më të kufizuara institucionale, mungesës së mbikëqyrjes efektive dhe aksesit më të vështirë në media apo shoqëri civile aktive.


Nga këndvështrimi ekonomik, kjo situatë mund të lidhet me “**efektin e qendrës**” (center-periphery effect): zonat qendrore, ku kultura administrative dhe qytetare është më perëndimore, kanë një nivel më të madh transparence dhe kontrolli, çka ul hapësirat për praktika korruptive.

¹⁶ <https://api.idracompany.com/asset/pdf/key-20250325093909-Korrupsioni-Krimi-Organizuar-ne-Shqiperi-2024.pdf>

Përkundrazi, në zonat periferike, qytetarët shpesh ndihen të detyruar të ofrojnë rryshfet edhe për shërbimet më bazike, një pjesë e mentalitetit të përhapur lidhur me marrëdhëniet me administratën.

Figura 12. Korrupsioni i shpërndarë në 12 qarqe

Intensiteti i korrupsionit të zyrtarëve




Kur qytetarët vlerësojnë procesin e vendimmarrjes në vendin e tyre, shumica duket se janë skeptikë ndaj përfaqësimit të interesit publik (Figura 13). Vetëm **10% e tyre besojnë se**

vendimet e qeverisë reflektojnë nevojat e qytetarëve, ndërsa pjesa më e madhe, **rreth 44%, mendon se vendimet favorizojnë partitë politike**. Pas tyre renditen elitat e biznesit, të cilat perceptohen si aktorë me ndikim të konsiderueshëm në formësimin e politikave publike. Kjo tregon një perceptim të qartë se vendimmarrja nuk fokusohet te interesi i përgjithshëm, por te interesat private të grupeve më të fuqishme në shoqëri.

Kjo perspektivë lidhet ngushtësisht edhe me përgjigjet e qytetarëve mbi arsyet kryesore pse korrupsioni mbetet i lartë në Shqipëri. Sipas tyre, burimi kryesor i këtij fenomeni është **korrupsioni i politikanëve dhe kapja e institucioneve** publike nga interesa private. Ky konstatim forcon idenë se korrupsioni nuk perceptohet thjesht si një devijim individual, por si një problem strukturor, i rrënjosur në marrëdhëniet midis politikës dhe aktorëve ekonomikë të privilegjuar. Në këtë kuptim, rezultatet nxjerrin në pah një krizë besimi ndaj institucioneve dhe theksojnë nevojën për rritjen e transparencës dhe ndarjes më të qartë midis interesit publik dhe atij privat.

Figura 13. Vendimet e qeverisë në shërbim të interesave personale



6. Përfundimet dhe Rekomandimet kryesore

6.1 Përfundimet kryesore

Raporti **mbi monitorimin e korrupsionit në Shqipëri** ofron një pasqyrë të hollësishme mbi përmasat, format dhe perceptimet e korrupsionit në vend. Analiza e të dhënave tregon se qytetarët shqiptarë po shfaqin një ndërgjegjësim më të lartë dhe një gatishmëri më të madhe për të sfiduar praktikën korruptive, duke synuar funksionimin e shoqërisë në përputhje me ligjin dhe institucionet. Studimi evidenton një kthesë të dukshme në kulturën qytetare, ku qëndrimet kritike dhe refuzimi i korrupsionit po fitojnë terren. Megjithatë, vërehet një hendek i qartë mes këtij progresi shoqëror dhe reagimit të institucioneve vendore, të cilat nuk kanë reflektuar ende plotësisht ndryshimet në normat dhe pritshmëritë qytetare. Analiza nxori në pah në mënyrë të detajuar se:

A. Përvoja me Korrupsionin:

- Një rritje e dukshme e përfshirjes në korrupsion: **59.0% e qytetarëve kanë dhënë ryshfet**, direkt ose indirekt, krahasuar me vitin 2023, që tregon përkeqësim të situatës.
- Presioni i drejtpërdrejtë nga zyrtarët mbetet i lartë: **54% e qytetarëve kanë pohuar se u është kërkuar ryshfet**, duke treguar një ekspozim të qëndrueshëm ndaj praktikave korruptive.
- Një ndryshim i rëndësishëm në mënyrën e dhënies së ryshfetit: vetëm **26.5% kanë dhënë ryshfet pas kërkesës direkte**, krahasuar me 44% në vitin 2023, që tregon se korrupsioni po normalizohet ose ndërmjetësohet në forma të tjera.
- **26% e qytetarëve kanë sjellje të miksuar**, duke konfirmuar ekzistencën e një grupi të ndërmjetëm me qëndrime ambivalente, i cili lëviz mes refuzimit dhe justifikimit të korrupsionit në varësi të rrethanave.
- Ekspozimi ndaj korrupsionit vazhdon të jetë më i lartë në sektorët kritikë, si shëndetësia, taksat dhe arsimit, ku qytetarët raportojnë raste të shpeshta kërkesash për ryshfet.

B. Qëndrimet ndaj Korrupsionit:

- Pjesa më e madhe e të intervistuarve shfaqin një qëndrim rezistent kundër korrupsionit: **69% nuk e konsiderojnë të pranueshme dhënien ose marrjen e ryshfetit nga zyrtarët publikë**, një rritje prej 4 pikë krahasuar me 2023.
- Normalizimi social i korrupsionit ka rënë ndjeshëm: vetëm **31% e qytetarëve e konsiderojnë ryshfetin të pranueshëm**, kundrejt 35% në 2023.
- **56% e qytetarëve janë të ndjeshëm ndaj korrupsionit**, ndërsa vetëm 18% janë të pandjeshëm, duke treguar një ndryshim pozitiv në kulturën qytetare.
- Ky rezultat është veçanërisht domethënës duke pasur parasysh se, tradicionalisht, ryshfeti perceptohet si praktikë e zakonshme edhe për shërbime elementare.
- Qytetarët po tregojnë një ndërgjegjësim më të madh për pasojat e korrupsionit në sektorë të ndryshëm dhe një qëndrim më kritik ndaj praktikave të padrejta nga politikanët dhe zyrtarët publikë.

C. *Perceptimet ndaj Korrupsionit:*

- Një ndryshim i dukshëm në perceptimin e grupeve profesionale të prekura: **pedagogët universitarë dhe zyrtarët e taksave** perceptohen si më të korrumpuar në vitin 2025, duke zëvendësuar zyrtarët e gjykatave dhe liderët politikë.
- Grupet më pak të korrumpuara mbeten **gazetarët dhe këshilltarët bashkiakë**, duke ruajtur stabilitetin në perceptimet publike.
- Qytetarët shfaqin pesimizëm për të ardhmen e korrupsionit: **77% besojnë se korrupsioni do të mbetet i pandryshuar**, ndërsa vetëm 22% shpresojnë për uljen e tij.
- Ky hendek mes qëndrimeve individuale dhe veprimeve institucionale tregon se ndërsa qytetarët po bëhen më rezistentë ndaj korrupsionit, institucionet ende nuk arrijnë të adresojnë plotësisht pritshmëritë dhe interesat e publikut.
- Rotacioni i grupeve profesionale të perceptuara si korruptive tregon ndjeshmërinë e qytetarëve ndaj ngjarjeve të fundit, transparencës së mediave dhe raportimeve të skandaleve.

6.2 Rekomandime kryesore

Në vitin 2025, Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit, duke përmirësuar mekanizmat e parandalimit, forcimin e institucioneve dhe rritjen e transparencës. Megjithatë, për të arritur rezultate më të prekshme dhe të qëndrueshme, është e nevojshme të vazhdohet me përpjekje të koordinuara dhe të përqendruara në disa fusha kyçe.

- **Forcimi i mbrojtjes së sinjalizuesve dhe krijimi i një kulture mbështetëse**
Është e domosdoshme të miratohen masa ligjore që sigurojnë mbrojtjen e sinjalizuesve, përfshirë masa kundër hakmarrjes dhe krijimin e kanaleve anonime për raportimin e rasteve të korrupsionit. Institucionet përgjegjëse duhet të ofrojnë mbështetje ligjore dhe psikologjike për individët që raportojnë korrupsionin, duke krijuar një mjedis të sigurt dhe mbështetës për ata që denoncojnë.
- **Pjesëmarrja aktive e shoqërisë civile dhe medias**
Shoqëria civile dhe media kanë një rol të rëndësishëm në monitorimin e veprimtarisë së institucioneve dhe në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut. Për këtë arsye, është e nevojshme të inkurajohen fushatat e ndërgjegjësimit dhe të mbështeten iniciativat e medias investigative. Gjithashtu, duhet të sigurohet pavarësia e medias dhe të krijohen kushte për një raportim të paanshëm dhe të besueshëm.
- **Reforma në drejtësi dhe forcimi i kapaciteteve të institucioneve**
Reforma në drejtësi duhet të vazhdojë, me fokus në emërimet e bazuara në meritë dhe në forcimin e kapaciteteve të institucioneve të drejtësisë. SPAK duhet të vazhdojë të zhvillojë aftësitë e tij hetimore, duke përdorur teknologji moderne dhe duke bashkëpunuar me agjenci ndërkombëtare për të luftuar korrupsionin në nivele të larta. Gjithashtu, duhet të sigurohet që proceset e vettingut të jenë të drejta dhe transparente.

- **Edukimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve**

Edukimi i qytetarëve për pasojat e korrupsionit dhe për mënyrat e raportimit të tij është thelbësor. Institucionet shtetërore dhe organizatat joqeveritare duhet të zhvillojnë programe edukative dhe fushata ndërgjegjësimi për të promovuar një kulturë të padurimit ndaj korrupsionit. Kjo do të ndihmonte në krijimin e një shoqërie më të angazhuar dhe më të përgjegjshme.

- **Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm**

Është e rëndësishme të vazhdohet me monitorimin dhe vlerësimin e masave të ndërmarra në luftën kundër korrupsionit. Kjo mund të arrihet përmes raporteve të pavarura, analizave të të dhënave dhe pjesëmarrjes së shoqërisë civile në proceset e monitorimit. Gjithashtu, duhet të sigurohet që rezultatet e këtyre monitorimeve të përdoren për të përmirësuar politikën dhe praktikën aktuale.

- **Fokus te rajonet periferike**

Është e nevojshme të forcohet zbatimi i mekanizmave të kontrollit dhe transparencës në qarqet ku perceptimi i korrupsionit është më i lartë. Trajnime intensive për zyrtarët lokalë dhe monitorimi i performancës së institucioneve mund të ndihmojnë në uljen e praktikave korruptive.

- **Reduktimi i mentalitetit të ryshfetit për shërbime bazike**

Shërbimet administrative, si regjistrimet e pronës apo lejet e ndërtimit, duhet të ofrohen përmes kanaleve online dhe procedurave të automatizuara, për të zvogëluar kontaktin e drejtpërdrejtë me zyrtarët dhe për të kufizuar mundësitë për dhënien e ryshfetit.

- **Fokus i drejtpërdrejtë në shërbimet me kontakt të lartë me qytetarët**

Shërbimet publike që kërkojnë ndërveprim të drejtpërdrejtë me qytetarët, si regjistrimet e pronës, lejet e ndërtimit apo shërbimet sociale, janë më të prekura nga praktikën e ryshfetit. Një strategji e efektshme është krijimi i kanaleve të automatizuara dhe online, kombinimi i tyre me inspektime të rregullta në terren, dhe trajnime specifike për zyrtarët që punojnë direkt me qytetarët. Kjo qasje mund të ulë presionin për dhurime ose ryshfet për shërbime bazike, duke targetuar pikërisht zonat dhe sektorët më të ndjeshëm.